



Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KAVAJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË
FITOJMË”, Z. ENEA DHIMITËR STEFA**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 1618 prot., datë 12.03.2024, këshilli i bashkisë Kavajë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Baki Muharem Dervishi, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë.”

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për këshillin e bashkisë Kavajë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 11, z. Enea Dhimitër Stefa.

Me shkresën nr. 944 prot., datë 8.04.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kavajë, z. Enea Dhimitër Stefa, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-BF-21949-1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Enea Dhimitër Stefa, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr 986 prot., datë 12.04.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr.985 prot., datë 12.04.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Enea Dhimitër Stefa.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Enea Dhimitër Stefa, në këshillin e bashkisë Kavajë.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.6370/1 prot., datë 17. 04. 2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Enea Dhimitër Stefa, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Enea Dhimitër Stefa, në këshillin e bashkisë Kavajë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Jona JOSIFI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KAVAJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË
FITOJMË”, Z. ENEA DHIMITËR STEFA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1618 prot., datë 12.03.2024, këshilli i bashkisë Kavajë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Baki Muharem Dervishi, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë.”

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për këshillin e bashkisë Kavajë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 11, z. Enea Dhimitër Stefa.

Me shkresën nr. 944 prot., datë 8.04.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kavajë, z. Enea Dhimitër Stefa, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Kavajë me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Enea Dhimitër Stefa

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-BF-21949-1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Enea Dhimitër Stefa, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 986 prot., datë 12.04.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 985 prot., datë 12.04.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Enea Dhimitër Stefa.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Enea Dhimitër Stefa, në këshillin e bashkisë Kavajë.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.6370/1 prot., datë 17. 04. 2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Enea Dhimitër Stefa, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Enea Dhimitër Stefa, në këshillin e bashkisë Kavajë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Enea Dhimitër Stefa.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI